



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2014
Nr. Dok. 201401967/6

Lënda: Rekomandohet *"Përmirësimi i punës për hetimin e shpejtë dhe pa zvarritje të pajustificuara të procedimeve penale, me qëllim zbatimin e dispozitave kushtetuese e proceduriale, për një proces të rregullt ligjor"*.

Drejtuar : Drejtuesit të Prokurorisë për Krime të Rënda
Z.Eugen BECI

Për dijeni: Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

TIRANË

Të nderuar Zotërinj,

Në veprimtarinë e punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë trajtimit të ankesave, qytetarë të ndryshëm kanë paraqitur shqetësime apo ngritur pretendime ndaj organit të Prokurorisë, për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal në ngarkim të tyre, apo pjestarëve të familjeve.

Ankesat e qytetarëve, ndonëse në raste më të pakta kanë qënë dhe ndaj Prokurorisë për Krime të Rënda, kjo dhe për shkak të objektit dhe rëndësisë të veprave penale të cilat ajo Prokurori heton. Kështu, ndërsa për vitin 2013, nga Institucioni i Avokatit të Popullit është trajtuar vetëm 1 ankesë, për vitin 2014, janë trajtuar 4 ankesa, të cilat paraqiten si më poshtë:

1.Rasti i ankesës me nr.201400035, e shtetasit S. K., i cili ka ngritur pretendimin se Prokuroria për Krime të Rënda ka zvarritur në mënyrë të pajustificuar hetimin e procedimit penal nr.171 të vitit 2013, filluar për veprën penale të *"Trafikimit të*

femrave” me të dëmtuar vajzën e tij F. K., parashikuar nga neni 114 i Kodit Penal, në ngarkim të dy personave të dyshuar si autorë të veprës penale.

2.Rasti i ankesës së shtetasit M. H., dhëndri i personit nën hetim Shaban Lami, për të cilën Prokuroria ka filluar procedimin penal nr.217 datë 25.10.2013, për veprën penale “*Vrasje në rrethana të tjera cilësuese*”, e mbetur në tentativë dhe e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 79/b, 25 e 22 të Kodit Penal. Ankuesi M. H., ka pretenduar se Prokuroria për Krime të Rënda jo vetëm ka zvarritur hetimin e procedimit penal ndaj personit nën hetim Sh. L., por dhe nuk ka marrë në shqyrtim e vlerësuar kërkesat me shkrim të paraqitura nga avokati mbrojtës i caktuar prej tij.

3.Rasti i ankesës me nr. 201401737, së shtetasit V. Ç., për të cilën Prokuroria ka filluar procedimin penal nr.2 të vitit 2014, për veprën penale të “*Trafikimit të narkotikëve*”, përfunduar hetimet e mandej dërguar çështja në gjyq në datën 12.11.2014. Edhe në këtë rast, personi nën hetim V. Ç., ka ngritur pretendimin për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimit penal dhe mosmarrje në pyetje për një periudhë të gjatë kohe nga momenti i caktimit të masës së sigurimit “*Arrest në burg*” nga gjykata. Për këtë rast, përfundimi i hetimit është realizuar në ditët e fundit të mbarimit të vendimit për zgjatjen e afatit të hetimit.

4.Rasti i ankesës me nr.20401967, e shtetasit D.M., nga Tirana, i cili ka ngritur pretendimin për zvarritje në hetimin e procedimit penal në ngarkim të djalit të tij Verdi Morava, ndaj të cilit Prokuroria ka filluar procedimin penal nr.275 datë 20.12.2013, për veprat penale të “*Rekrutimit të personave për kryerjen e veprave penale me qëllime terroriste, ose financimit të terrorizmit*” dhe “*Nxitjes, thirrjes publike dhe propogandës për kryerjen e veprave me qëllime terroriste*”, parashikuar nga nenet 231 dhe 232/a të Kodit Penal. Personi nën hetim V. M., veç sa sipër, ka pretenduar dhe për akuzë e arrestim të padrejtë në ngarkim të tij.

Për trajtimin e ankesave, nga ana e jonë është proceduar nëpërmjet dërgimit të shkresave “*kërkesa për informacion*” drejtuar Prokurorisë për Krime të Rënda, si dhe në kontaktet me drejtuesit apo prokurorët që kanë hetuar çështjet, tek të cilët kemi gjetur mirëkuptimin për çdo rast të hetuar si dhe predispozicionin e nevojshëm për marrjen e përgjigjeve në kohë, vijim i praktikave të mira të bashkëpunimit mes dy institucioneve. Në trajtimin e ankesave, kemi mbajtur parasysh rëndësinë e veprave penale të hetuara nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe rrethana të tjera që lidhen me vështirësitë në kryerjen e veprimeve hetimore, numerin e madh të personave nën hetim etj. Në rast të veçanta, nga ana e jonë është kryer dhe një hetim i pavarur administrative, i cili ka konsistuar në kontaktin me ankuesin si dhe marrjen e deklarimeve të tij. I tillë është rasti i personit nën hetim V. M., duke patur parasysh dhe faktin se i paraburgosuri kishte hyrë në grevë urie, me pretendimin se ndaj tij është ngritur akuzë e padrejtë nga organi procedues. Duke analizuar ankesat e mësipërme, arrijmë në disa konstime e përfundime, dhe konkretisht:

Së pari: Objekti i ankesave është zvarritja e pajustificuar e hetimit të procedimeve penale, e për rrjedhojë marrja e vendimeve për zgjatjen e afatit

të hetimit ka qënë e panevojshme, kurse për rastin e ankesës së shtetasit V. M., ai ka pretenduar se akuza dhe arrestimi i tij janë të padrejta.

Së dyti: Vendimet për zgjatjen e afatit të hetimit janë marrë disa herë në një procedim penal, nga organi procedues. Në ankesat e tyre personat nën hetim pretendojnë se organi procedues nuk i ka njohur ata ose përfaqësuesit e tyre, avokatët mbrojtës, me vendimet për zgjatjen e afatit të hetimit, mosveprim i cili vjen ndesh me nenin 324 pika 3 e Kodit të Procedurës Penale. Është rasti për të sugjeruar që, njohja me vendimet për zgjatjen e afatit të hetimit, personave nën hetim apo avokatëve mbrojtës të tyre të bëhet nga Prokurori duke shkuar në vend në I.E.V.P dhe jo duke dërguar shkresat bashkë me vendimet Administratës së Institucioneve të Paraburgimit, që këta të fundit t'ja u dorëzojnë të paraburgosurve.

Së treti: Në mosshqyrtimin dhe mosvlerësimin e *“Kërkesave apo memorieve me shkrim”* të paraqitura nga avokatët mbrojtës të personave nën hetim, gjatë fazës së hetimit paraprak, çka vjen ndesh me nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale.

Së katërti: Në përgjigjet me të njëjtën përmbajtje, që Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, i ka kthyer shkresave *“Kërkesë për informacion”*, Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe zvarritja në hetim është arsyetuar me *“... kryerjen e një hetimi kompleks, se veprat penale kanë shtrirje të madhe si në kohë ashtu dhe në subjekte... por brënda normave dhe afateve procedurale të parashikuara në ligj..”*

Institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion i pavarur kushtetues, ka për mision mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve edhe në procesin penal ndaj personave që organ i procedues ka ngritur një akuzë, kur me veprimet apo mosveprimet e tij, i cënon ato të drejta.

Të drejtat e personave ndaj të cilëve është ngritur një akuzë, parashikohen në nenet 42/2 dhe 131 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 6 të KEDNJ si, dhe nenet 323 e 324 të Kodit të Procedurës Penale. Pra, mbrojtja që i ofrohet individit nga klauzola e procesit të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në Kushtetutë, por dhe në të drejtat e njohura nga ligji.

E drejta për një proces të rregullt ligjor është një e drejtë kushtetuese, e cila e vendos organin procedues para një detyrimi për të vënë në dijeni individin menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij, pra ta informojë atë në mënyrë të plotë dhe të saktë për akuzat e ngritura. Mandej, gjatë zhvillimit të fazës së hetimit paraprak deri në përfundimin e hetimit dhe dërgimit të çështjes në gjyq, të respektojë të gjitha të drejtat procedurale të personit ndaj të cilit ka ngritur një akuzë.

Kushtetuta e Republikës të Shqipërisë në nenet 28 dhe 42 të saj, përcakton detyrimin për gjykimin e personit të paraburgosur apo të akuzuar penalisht brënda një *“afati të arsyeshëm”*. Ky afat mendojmë se nënkupton një hark kohor të nevojshëm për zhvillimin e një procesi penal, i cili duhet të sigurojë një barazi ta palëve në proces. Ky rregull shpreh parimin e barazisë së palëve në proces duke i dhënë hetimit dhe gjykimin afatin e nevojshëm, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare të organit procedues.

Për cilindo që është i akuzuar për një vepër penale dhe që është mbajtur në gjëndje arresti, shpejtimi i procedurave të hetimit e gjykimit është i lidhur drejtpërsëdrejti me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e reflektuar kjo dhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese, kanë përcaktuar kritere të cilat bëjnë fjalë për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedimit, me qëllim që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt duke u siguruar dhe një shpejtësi e mjaftueshme. Për të mënjanuar cënimin e kriterit të afatit të arsyeshëm veprimet e organit procedues nuk duhet të rezultojnë të pamjaftueshme, pasi krijojnë hapësira për zvarritje të procesit të hetimit të çështjes.

Edhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, kur flet për kompleksitetin e çështjes ka parasysh përfshirjen e natyrës dhe rëndësinë e krimit, numurin e akuzave me të cilën vihet përballë i pandehuri, natyrën e hetimit që kërkohet dhe numurin e njerzve të përfshirë në krim, si dhe të dëshmitarëve. Nga analiza e këtij elementi vlerësohet dhe standarti i kohës së arsyeshme që nevojitet për përfundimin e hetimit apo gjykimit të çështjes.

Rregullorja e Prokurorisë së Përgjithshme *“Për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale e morale të prokurorëve”*, e datës 17.06.2014, përcakton në mënyrë të qartë se kush përfshihet në procedimet komplekse. Por, nga ana tjetër në rregullore përcaktohen dhe detyrimet e Prokurorit për të kryer një punë me cilësi, për planifikimin e saj dhe caktimin e afateve kohore për çdo çështje, për të drejtuar me efektivitet hetimet, për të organizuar, drejtuar dhe kontrolluar punën e policisë gjyqësore e në përfundim për të respektuar shpejtësinë dhe afatet e arsyeshme ligjore dhe atyre të motivuara të hetimeve paraprake deri në zgjidhjen ligjore të çështjes.

Pavarësisht faktit të kryerjes hetimeve komplekse, mendojmë se Prokuroria ka patur mundësitë reale dhe objektive për të përfunduar hetimet në kohë më të shkurtër, çka realizohet nëpërmjet organizimit të mirë të punës, kryerjes së veprimeve hetimore në vazhdimësi, marrjes, shqyrtimit, vlerësimit dhe verifikimit të pretendimeve të personit nën hetim etj. Për rrjedhojë për këto raste, do të sugjerim bërjen e një analizë për zvarritjet e hetimit të procedimit penal, jo vetëm duke nxjerrë shkaqet dhe personat përgjegjës për to, por ajo çka është e rëndësishme marrjen e masave për përmirësimin e punës në këtë drejtim. Objekt i analizës duhet të jenë dhe procedimet penale që ndodhen në fazën e hetimit paraprak, si një obligim për organizimin e punës me qëllim hetimin efikas dhe të shpejtë të çështjeve.

Veç sa sipër, do të sugjerim që nga ana e Prokurorisë duhet të bëhet kujdes dhe zbatohen me rigorozitet jo vetëm dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, por edhe aktet normative të Prokurorisë së Përgjithshme si, rregullorja, urdhërat apo udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe nenin 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* me ndryshimet përkatëse, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit.....paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*.

REKOMANDOHET

Rekomandohet *“Përmirësimi i punës për hetimin e shpejtë dhe pa zvarritje të pajustificuara të procedimeve penale, me qëllim zbatimin e dispozitave kushtetuese e procedurale, për një proces të rregullt ligjor”*.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na vini në dijeni brënda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI